



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Mitrovicë

AD.PTHM.nr.3/2024

Prokuroria Themelore Mitrovicë – U.D Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Mitrovicë Njazi Rexha, duke vendosur në çështjen disiplinore sipas Ankesës së parashtruar nga ankuesi N.B. me datë 06.11.2024 ndaj Prokurorit të Shtetit A.Z., pas vlerësimit të ankesës së parashtruar dhe pranimit të deklaratës nga Prokurori i Shtetit, në mbështetje të nenit 9 par.1 nën par.1.5 dhe par.6 të Ligjit Nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nenit 6 par.1, par.4 dhe nenit 7 par.1, par.3 nën par.3.2 dhe par.4 të Rregullores 05/2019 për procedurën disiplinore të prokurorëve, me datë 03.12.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar Ankesa disiplinore e datës 06.11.2024 e regjistruar me numër të Lëndës AD.PTHM.nr.3/2024 e parashtruar nga ankuesi N.B. kundër Prokurorit të Shtetit A. Z., me pretendime se ka bërë shkelje të natyrës disiplinore të detyrës së prokurorit, duke aluduar në dispozitën e nenit 6 par.2 nën par.2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për mostrajtim adekuat profesional të çështjes penale PP.II.nr... me të pandehurit Rr.M. dhe T.M. për shkak të veprës penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, ku i dëmtuar është N. B., për arsye se nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Zyra e U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nga zyra e Prokurorisë së Shtetit në Prishtinë ka pranuar parashtresën e karakterit disiplinor të paraqitur nga Z.N. B. më dt.06.11.2024 që është kërkuar inicim i procedurës disiplinore ndaj prokurorës Znj.A. Z.me pretendime se ka bërë shkelje të natyrës disiplinore që i referohet shkeljes së detyrës së prokurorit sipas nenit 6 par.2 nën par.2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për mostrajtim adekuat dhe profesional në çështjen penale PP.II.nr....

Pas shikimit dhe analizimit të pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi janë ndërmarrë veprime në raport me prokuroren Znj. A. Z., janë siguruar shkresat e Lëndës PP.II.nr... lidhur me rastin, kallëzimi penal nr.IPK/DH/./../V. i dt.24.02.2021, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të pandehurve Rr. M. dhe T. M. të datës 18.02.2021, Procesverbalin mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit N. B. me datë 28.01.2021, Procesverbalet e seancave gjyqësore, CD- video incizimet po ashtu është siguruar edhe Deklarata e dt.26.11.2024 e përpiluar nga prokurorja Znj.A. Z.

Duke i analizuar dhe shpjeguar në mënyrë të gjithanshme të gjitha rrethanat e rastit dhe pretendimet e palës ankuese rezulton se: Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritë Aktakuzën PP.II... i dt.20.09.2021 ndaj të pandehurve Rr. M. dhe T. M. që të dy zyrtar policor në drejtim të veprës penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i përgjithshëm me Aktgjykimin P.nr... të dt.12.09.2023 të pandehurin Rr. M. e ka shpall fajtor për veprën penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim do të ekzekutohet në afat

prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në mbështetje të nenit 44 dhe me pëlqimin e të pandehurit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh i zëvendësohet në dënimin me gjobë në shumë prej 3.000 euro.

Pala e dëmtuar N. B. realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Ndërsa të pandehurën T. M. e ka liruar nga Akuza për shkak të veprës penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK.

Kundër këtij aktgjykimi Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur Ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 par.1 të KPPK dhe Vendimit mbi sanksionin penal nga neni 387 par.1 të KPPK.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktgjykimin PA1.nr... të datës 29.09.2024, aprovon pjesërisht ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Rr. M., av.G. I. Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr... i datës 12.09.2023 sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që kolegji penal i kësaj Gjykate të akuzuarit Rr. M. për veprën penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1500 Euro të cilin dënim do ta paguaj në afat prej tre muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë për çdo 20 Euro do t' i llogaritet një ditë burgim.

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore Mitrovicë.

Hudhet poshtë si e palejuar ankesa e palës së dëmtuar N. B..

Në pjesë të tjera aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

Sa i përket parashtresës së ankuesit Z.N. B. edhe më parë te U.D. Kryeprokurori i Shtetit në Prishtinë ka paraqitë ankesë për të njëjtën çështje më dt.04.10.2023, për çka Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë me njoftimin e dt.23.10.2024 ka informuar Prokurorin e Shtetit në Prishtinë mbi ecurinë e lëndës. Mirëpo, me të pranuar vendimin e Gjykatës së Apelit, për të cilën konsideron se është skandaloz, përsëri paraqet ankesën e datës 06.11.2024.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se Avokati M. H. gjatë seancës gjyqësore të datës 14.07.2023 ka pyetur prokuroren A. se: “a je shit hala, apo a shitesh”, dhe e njëjta nuk e ka lajmëruar rastin, është përgjegjësi e gjyqtarit që ta mbajë rendin në shqyrtimin gjyqësor për fjalët e veprimet që ndërmerren gjatë seancës gjyqësore. Njëherit, nga procesverbali i datës 14.07.2023 nuk mund të vërtetohet se a i janë drejtuar këto fjalë prokurores nga ana e avokatit, e nga Deklarata e prokurores A. Z. rezulton se nuk i kujtohet se a i ka folur avokati këto fjalë, sido që të jetë për sjellje të pahijshme të avokatit pala ankuese duhet ti drejtohet Odës së Avokatëve të Kosovës.

Lidhur me fjalët e përdorura kinse nga avokati në shqyrtimin gjyqësor ndaj prokurores, kemi kërkuar informacione se a është inicuar ndonjë procedurë disiplinore për gjyqtarin e rastit, rezulton se është inicuar procedura disiplinore AD.GTHM.nr... i dt.24.08.2023 dhe është refuzuar ankesa e parashtresës Z.N. B..

Sa i përket faktit se prokurorja nuk ka bashkëpunuar me të dëmtuarin dhe avokatin e tij për ankesë, rezulton se prokurorja e ka kryer obligimin e vet ligjor brenda afatit të caktuar ligjor ka ushtruar ankesë për shkak të Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe Vendimit mbi sanksionin penal, mirëpo autoriteti kompetent vlerëson se pakënaqësitë e palëve të marrja e vendimit, respektivisht tek lartësia e dënimit nuk mund të konsiderohen shkelje disiplinore, për arsye se palët mund ta atakojnë aktgjykimet me ankesa.

Në bazë të pretendimeve të palës ankuese dhe të gjitha të cekurave më lartë, konsideroj se të njëjtat pretendime nuk ndërlidhen me shkelje të natyrës disiplinore sipas nenit 6 par.2 nën par.2.1 të Ligjit për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Andaj, për arsye të cekura më lart parashtresa me karakter disiplinor konsiderohet e mbyllur A/A.

